

LIGJ
Nr.9260, datë 15.7.2004

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7748, DATË 29.7.1993 "PËR
STATUSIN E ISH-TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË NGA
SISTEMI KOMUNIST", I NDRYSHUAR**

(Ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 20.12.2005)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

(Shfuqizuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 20.12.2005)

Neni 2

Pas nenit 21 shtohet neni 21/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 21/1

Për zbatimin e këtij ligji ngrihet një komision i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Komitetit të Integritetit të të Përndjekurve Politikë.

Organizimi dhe funksionimi i këtij komisioni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Pas nenit 21/1 shtohet neni 21/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 21/2

Kundër vendimeve të Komisionit, të parashikuar në nenin 2 të këtij ligji, mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Neni 4

Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 1 dhe 2 të tij.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4296, datë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu